

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8311  
E martë, 2 qershor 2026  
Çmimi 0.50 €

Edhe në Kosovë  
shënohet Dita  
Ndërkombëtare  
e Fëmijëve | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ZGJEDHJET NË SERI FORCOJNË NARRATIVIN E "SHTETIT TË PAPËRFUNDUAR"

| FAQE 4-5



Zgjedhjet në Kosovë nuk mjaftojnë më për ta vlerësuar cilësinë e demokracisë nëse nuk ndiqen me qëndrueshmëri institucionale. Bllokimet e shpeshta paszgjedhore kanë

ndryshuar mënyrën se si vendi perceptohet ndërkombëtarisht, duke zhvendosur fokusin nga procesi zgjedhor te kapaciteti për qeverisje. Më 7 qershor Kosova shkon në

zgjedhjet e treta parlamentare brenda 18 muajve - një ritëm që e largon ciklin zgjedhor nga normaliteti demokratik dhe e vendos atë në logjikën e krizës së përsëritur

### AKTUALE



RAMA MBRON INVESTIMIN  
E DHËNDRIT TË TRUMPIT NË  
ZVËRNEC PAS PROTESTAVE NË  
SHQIPËRI | F. 2

SHBA-JA KRYEN SULME TË REJA  
'VETËMBROJTËSE' NË IRAN | F. 2

NË UASHINGTON DISKUTOHET  
NJOHJA E KOSOVËS NGA GREQIA | F. 6

### EKONOMI



ZGJEDHJE TË REJA, PROGRAME  
TË VJETRA POLITIKE: KUSH  
PO E MASHTRON EKONOMINË  
E KOSOVËS? | F. 7

ZEKA: GAZI NGA SHBA-JA,  
VENDIMTAR PËR SIGURINË  
KOMBËTARE TË KOSOVËS | F. 8

### SPORT



"DARDANËT" RIKTHEHEN NË  
STËRVITJE | F. 11



MIDIS  
HISTORISË  
DHE LIDERIT:  
SI VENDOSËT  
VOTA NË  
KOSOVË? | F. 3

KOMF-I,  
SUBJEKTEVE  
POLITIKE:  
SHMANGNI  
ÇDO FORMË TË  
PËRFSHIRJES  
SË FËMIJËVE NË  
AKTIVITETET  
E FUSHATËS  
ZGJEDHORE | F. 8



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## RAMA MBRON INVESTIMIN E DHËNDRIT TË TRUMPIT NË ZVËRNEC PAS PROTESTAVE NË SHQIPËRI

**TIRANË, 1 QERSHOR** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e mbrojti projektin për ndërtimin e një resori në Zvërnec, afër Vlorës, të cilin e cilësoi “të jashtëzakonshëm”. Ky është reagimi i parë i Ramës pas protestave kundër këtij investimi, ku u lëndua edhe një qytetar.

Zona ku kanë nisur punimet për ndërtimin e një resori është pjesë e një peizazhi të mbrojtur me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ajo konsiderohet ndër habitatet më të rëndësishme në Shqipëri për zogjtë e ujit dhe migratorët, përfshirë dhe flamingot. Punimet lidhen me planet e

shpallura më herët nga Jared Kushner, dhëndri i presidentit amerikan Donald Trump, i cili në mars të vitit 2024 deklaroi se synon të ndërtojë hotele dhe qindra vila në zonën e Zvërnecit. Radio Evropa e Lirë i është drejtuar për koment kompanisë së Kushnerit lidhur me zhvillimet e fundit në Shqipëri.

Kryeministri i Shqipërisë, Rama, tha se projekti ka nisur si interesim nga ana e investitorëve më 2023. “Ka qenë një interesim bashkë me Sazanin. Qëndrimi ynë ka qenë se Sazani është tokë publike dhe jemi të gatshëm të punojmë me ju, por ajo tokë nuk shitet, shteti shqiptar do të jetë palë, ortak.

Për projektin e Zvërnecit u kemi bërë të qartë se duhet ta zgjidhin me pronarët. Ky është fillimi”, tha Rama gjatë mbledhjes së grupit parlamentar të Partisë Socialë të cilën e drejton.

Ai shtoi se të gjithë e dinë se kush janë palët e interesuara për këtë projekt. “Bota e mbarë flet për këtë projekt për shkak të njeriut që e ka promovuar atë, Jared Kushner, por bota ka hesape për të larë dhe luftërat e veta për të bërë, ndaj edhe projekti ka pasur interesimin e mediave amerikane dhe evropiane, por me agjendë, jo për të informuar për zhvillimin e Shqipërisë por për të gjetur ‘gjilpëra në kashtë’. Ndaj



investitorët kanë angazhuar ekselencën botërore, në arkitekturë, inxhinieri, mjedis, aspektin juridik, etj”, tha Rama. Sipas tij, qeveria shqiptare ka

mbrojtur interesin e vendit, duke theksuar se një projekt i vjetër është refuzuar nga autoritetet sepse “kërkuam standarde të larta”.

## KALLASI BËN THIRRJE PËR ‘BISEDIME MË TË THELLA’ PËR RAKETAT DHE REZERVAT BËRTHAMORE TË IRANIT

**BRUKSEL, 1 QERSHOR** - Çdo marrëveshje e përkohshme për paqe ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Iranit duhet të pasohet nga bisedime më të thella mbi rezervat bërthamore të Teheranit, raketat dhe çështje të tjera kritike, theksoi të hënën shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Kaja Kallas. Duke folur në një konferencë për shtyp në Islamabad, Kallas tha se sheh një “mundësi të brishtë diplomatike” për ta zgjatur armëpushimin e tanishëm dhe për ta rihapur Ngushtica e Hormuzit, pavarësisht shkëmbimit të sulmeve gjatë natës nga Irani dhe Shtetet e Bashkuara. “Çdo mirëkuptim i përkohshëm midis ShBA-së dhe Iranit duhet të pasohet nga bisedime më të thella mbi



rezervat bërthamore të Teheranit dhe çështje të tjera kritike”, tha diplomatja më e lartë e bllokut evropian në konferencën e përbashkët për shtyp me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Jashtëm të Pakistanit, Ishaq Dar.

Kallas vlerësoi rolin e Pakistanit si ndërmjetës në krizën e Gjirit

dhe shprehu gatishmërinë e BE-së për të kontribuar në zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjes SHBA-Iran, duke përmendur “ndikimin ekonomik” të bllokut, “ekspertizën e fituar me vështirësi në fushën bërthamore”, “marrëdhëniet afatgjata me partnerët në të gjithë Gjirin” dhe “angazhimin e

drejtpërdrejtë me vetë Iranin”. “Shoh një rol konkret për BE-në në ndihmën për ta bërë çdo marrëveshje të ardhshme të qëndrueshme - qoftë përmes operacioneve detare apo përmes stimujve ekonomikë që mbështesin stabilitetin afatgjatë”, tha ajo, duke sugjeruar “kushte të rrepta” për një “rrugë të kalibruar drejt lehtësimit të sanksioneve” ndaj Iranit.

ShBA-ja dhe Izraeli nisën sulme ajrore kundër Iranit më 28 shkurt, pas mosmarrëveshjeve të vazhdueshme lidhur me kapacitetet bërthamore të Iranit. Pakistani ka ndërmjetësuar mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit për të arritur një armëpushim të përhershëm, pasi një armëpushim i brishtë u arrit më 8 prill.

Një draft-marrëveshje, e ndërmjetësuar nga Pakistani, ka kaluar vazhdimisht nga njëra palë te tjetra, ndërsa presidenti amerikan, Donald Trump, deklaroi më 31 maj se fokusi mbetet te kapaciteti bërthamor i Iranit.

Në një postim në rrjetet sociale, Trumpi tha se marrëveshja e tij “përcakton shumë qartë se Irani nuk do të ketë armë bërthamore”.

Gjatë luftës, Teherani dhe Uashingtoni ndërmorën masa që praktikisht çuan në mbylljen e Ngushticës së Hormuzit, gjegjësisht detare që ka rëndësi jetike dhe strategjike, sepse përmes saj kalon pothuajse 20 për qind e furnizimit botëror me naftë nga Gjiri drejt tregjeve ndërkombëtare.

## SHBA-JA KRYEN SULME TË REJA ‘VETËMBROJTËSE’ NË IRAN

**WASHINGTON, 1 QERSHOR** - Dhuna sërish ka shpërthyer në Lindjen e Mesme, me ushtrinë amerikane që tha se ka kryer rindin e tretë të sulmeve “vetëmbrojtëse” ndaj caqeve në Iran, teksa Teherani është kundërpërgjigjur me sulme me raketa dhe dronë ndaj Kuvajtit në orët e para të 1 qershorit. “Komanda Qendrore amerikane [CENTCOM] ka kryer sulme vetëmbrojtëse ndaj radarëve iranianë dhe qendrave të komandës dhe kontrollit për dronët në Goruk të Iranit dhe në ishullin Keshm gjatë fundjavës”, tha entiteti i ushtrisë amerikane që është përgjegjëse për forcat e ShBA-së në Lindjen e Mesme. Ky është të paktën sulmi i tretë “vetëmbrojtës” që ShBA-ja ka thënë se ka kryer ndaj caqeve iranianë që kur ka hyrë në fuqi armëpushimi në fillim të prillit. Sulmet e reja vijnë në kohën kur zyrtarët amerikanë dhe iranianë po shkëmbejnë një sërë propozimesh për një kornizë që

do të zgjaste armëpushimin aktual edhe për 60 ditë, si dhe potencialisht do të hapte Ngushticën e Hormuzit dhe do të hiqte bllokadën amerikane ndaj porteve iranianë, mes çështjeve të tjera që po diskutohen.

CENTCOM-i tha përmes deklaratës se sulmet ishin, të paktën pjesërisht, në përgjigje të rrëzimit të një droni nga forcat iranianë.

CENTCOM-i i përshkroi sulmet si “sulme të matura dhe të qëllimshme, të kryera të shtunën dhe të dielën, në përgjigje të veprimeve agresive iranianë, të cilat përfshinin rrëzimin e një droni amerikan MQ-1 që po operonte mbi ujëra ndërkombëtare”.

Në njoftim u tha se aeroplanët luftarakë amerikanë u përgjigjën “duke eliminuar mbrojtjet ajrore iranianë, një stacion kontrolli në tokë dhe dy dronë që paraqisnin kërcënim të qartë për anijet që po kalonin nëpër ujërat rajonale”.



Sipas CENTCOM-it, asnjë pjesëtar i ushtrisë amerikane nuk u lëndua gjatë këtij operacioni. Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) i Iranit u citua nga mediat shtetërore iranianë të ketë thënë se forcat e tij kishin shënjestruar një bazë ajrore që është përdorur nga forcat amerikane për të kryer sulmet e fundit, pa specifikuar se në cilin shtet ndodhej baza.

Megjithatë, në të njëjtën kohë,

ushtria e Kuvajtit njoftoi se mbrojtja e saj ajrore po përballej me “sulme armiqësore me raketa dhe dronë”, ndërsa sirenat që paralajmërojnë sulmet ajrore u dëgjuan në këtë shtet të vogël të Gjirit Persik që është aleat i ShBA-së.

Në një postim në X, ushtria tha se “nëse dëgjohen shpërthime, ato janë rezultat i sistemeve të mbrojtjes ajrore që po pengojnë sulmet armiqësore. Të gjithë

qytetarëve u kërkohet t’u përmbahen udhëzimeve të sigurisë dhe mbrojtjes të lëshuara nga autoritetet kompetente”.

Ushtria e Kuvajtit nuk tha menjëherë nëse predhat u lëshuan nga Irani, por shteti i Gjirit shpesh ka qenë cak i sulmeve hakmarrëse nga Teherani, i cili ka pretenduar se sulmet amerikane janë nisur nga territori i tij.

Forcat amerikane kryen sulme më 7 maj, pas sulmeve që përfshinin raketa iranianë, dronë dhe mjete të vogla lundruese të drejtuara kundër anijeve ushtarake amerikane.

Uashingtoni po ashtu kreu sulme më 25 maj dhe më 27-28 maj kundër vendeve nga ku lëshohen raketat, ndaj anijeve që përdoren për të vendosur mina detare dhe caqeve të tjera ushtarake, të cilat ShBA-ja tha se përbënin kërcënim për forcat amerikane dhe transportin tregtar në Ngushticën e Hormuzit.

# MIDIS HISTORISË DHE LIDERIT: SI VENDOSSET VOTA NË KOSOVË?



**PRISHTINË, 1 QERSHOR** - Në sheshin e Drenasit qëndrojnë nëntë shtatore. Në këtë qytet me rreth 48 mijë banorë, në pjesën qendrore të Kosovës secila prej tyre përfaqëson një histori nga lufta: nga tri shtatorët e vëllezërve Adem, Shaban e Hamëz Jashari deri tek ajo e mjekut Hafir Shala, që është ende i pagjetur.

Lufta e fundit në Kosovë gjatë viteve 1998-99 ka përcaktuar shumëçka për këtë qytet të Drenicës - rajonin që ishte ndër më të prekurit nga pasojat e saj. Për shkak se ishte vatër kryesore e rezistencës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), banorët e kësaj zone pësuan humbje të mëdha si në njerëz ashtu edhe në pasuri.

Tani, 27 vjet më vonë, shumë prej tyre vazhdojnë të votojnë për Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), që është themeluar në vitin 1999 nga udhëheqës të UÇK-së.

## Bastioni i PDK-së në Drenicë

Në asnjë komunë të banuar me shumicë shqiptare Lëvizja Vetëvendosje nuk mori rezultat më të dobët sesa në dy komunat e rajonit të Drenicës, në Skenderaj dhe Drenas, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të dhjetorit të vitit të kaluar. Në këto dy komuna ka fituar historikisht Partia Demokratike e Kosovës.

Ish-udhëheqësi i kësaj partie, Hashim Thaçi - që aktualisht po

pret aktgjykimin në Hagë për akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit - ishte gjithashtu kryeministër në shkurt të vitit 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë.

Kjo histori e partisë bën që shumë banorë të Drenasit me të cilët foli Radio Evropa e Lirë, të mos e vënë në dyshim zgjedhjen e tyre politike.

Ruzhdi Orana, ish-pjesëtar i UÇK-së, është njëri ndër ta. "Pjesëtarët e UÇK-së e formuan PDK-në. Po aty nisi rruga drejt pavarësisë, që e solli prapë kjo parti. Për mua do të ishte mëkat i madh nëse do të votoja një parti tjetër", thotë Orana për REL-in.

Ai thekson se historitë e luftës dhe vuajtjes janë transmetuar nga gjeneratat e vjetra te të rinjtë dhe kështu, në këtë rajon, është ndërtuar një ndjenjë besnikërie që i tejkalon programet politike.

Shyqyri Hoxha, nga e njëjta komunë, mban të njëjtin qëndrim. "Drenica s'mund ta lërë PDK-në se ne e dimë çka është lufta. S'mund të largohemi prej PDK-së", thotë ai.

Të njëjtin frymë besnikërie e ka gëzuar edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ndër vite, për shkak të ish-liderit të saj, Ibrahim Rugova, që ka udhëhequr rezistencën paqësore ndaj ish-regjimit serb. Gati dy dekada pas vdekjes së Rugovës, djali i tij, Ukë Rugova, u kthye sërish në politikë. Në zgjedhjet e parakohshme të dhjetorit të vitit të kaluar, me

gati 50 mijë vota, ai ishte i treti më i votuari në listën e LDK-së.

"Rugovizmi jeton! rugovizmi fiton!" shkroi së fundi e para në listën e kësaj partie për zgjedhjet parlamentare që do të mbahen më 7 qershor, Vjosa Osmani, në një postim në Facebook pas një tubimi elektoral.

Në të kaluarën, ndër bastionet e kësaj partie ka qenë Komuna e Podujevës, e që tani është shndërruar në një vend ku Lëvizja Vetëvendosje (LV) fiton rreth 60 për qind, e i ka fituar edhe zgjedhjet lokale.

Në këtë komunë, madje, një qytetar ka ndërtuar një statujë të udhëheqësit të LV-së, Albin Kurti, tani kryeministër në detyrë.

Atë e ka vendosur para shtëpisë së tij, duke e titulluar "shpresa e fundit".

Këto dy forma të lidhjes politike, me historinë e partisë dhe me figurën e liderit, pasqyrojnë edhe gjetjet e një sondazhi të kompanisë kërkimore, UBO Consulting, sipas të cilit ato janë faktorët kryesorë që ndikojnë në votën e qytetarëve në Kosovë.

Në këtë kontekst, Bryan McGraw, profesor i Shkencave Politike në kolegjin amerikan Wheaton, thekson se demokracitë moderne kudo në botë po përjetojnë një lloj transformimi në mënyrën se si funksionojnë partitë dhe si bëhet përzgjedhja politike.

Sipas tij, dobësimi i partive si institucione dhe rritja e rolit të liderëve individualë janë

rezultat i reformave institucionale dhe ndryshimeve në komunikim politik.

"Partitë janë dobësuar nga ndryshimet në sistemet zgjedhore dhe nga rritja e ndikimit të mediave dhe rrjeteve sociale, të cilat e bëjnë më të lehtë për liderët të komunikojnë drejtpërdrejt me votuesit dhe t'i anashkalojnë strukturat partiake", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

McGraw argumenton gjithashtu se kjo sjell një efekt zinxhiror: fushatat bëhen gjithnjë e më personale, partitë gjithnjë e më shumë shndërrohen në "brendë" dhe më pak në institucione që prodhojnë politika, ndërsa përgjegjësia politike bëhet më e vështirë për t'u identifikuar.

Në këtë proces, sipas tij, votuesit shpesh orientohen më shumë nga figura dhe spektakli politik sesa nga programet konkrete.

Ai thekson se në sisteme të tilla, edhe votimi i informuar bëhet më i vështirë.

Në Kosovë, kjo dinamikë merr një dimension të veçantë, duke qenë se zgjedhjet parlamentare të qershorit do të jenë zgjedhjet e treta parlamentare që nga shkurti i vitit të kaluar.

Ky cikël i shpeshtë elektoral e mban vazhdimisht politikën në fushatë. "Nëse votuesit do të marrin vendime politike kryesisht bazuar në 'lajmet' që marrin nga rrjetet e tyre sociale, nuk duhet të presim aspak që ato zgjedhje të jenë të mirinformuara", përfundon

McGraw.

"Radio Evropa e Lirë" ka raportuar në të kaluarën se si partitë politike dhe përfaqësuesit e tyre kanë shpenzuar dhjetëra mijëra euro për reklama në rrjete sociale gjatë fushatave elektorale, për ta arritur audiencën e targetuar nga ta.

E njëjta gjë shihet edhe tani, në prag të zgjedhjeve të reja parlamentare. Në shtatë ditët e fundit, shpenzuesit më të mëdhenj dalin të jenë Ardian Gjini i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës me gati 3 mijë euro, Bedri Hamza i PDK-së me rreth 2.100 dhe Uran Ismaili i PDK-së me rreth 1.300.

Pothuajse të gjitha postimet e sponsorizuara janë thirrje për mbështetje dhe përmbledhje të aktiviteteve nga tubimet elektorale.

## Lideri i partisë mbetet faktori kryesor që ndikon votën në Kosovë

Vendimi i qytetarëve të Kosovës për të votuar një parti politike ndikohet më së shumti nga lideri i partisë. Pas tij renditet historia e partisë, ndërsa programi politik dhe lista e kandidatëve kanë ndikim më të ulët në vendimmarrjen e votuesve.



## ZGJEDHJET NË SERI FORCOJNË NARRATIVIN E 'SHTETIT TË PAPËRFUNDUAR'

**PRISHTINË, 1 QERSHOR** - Zgjedhjet në Kosovë nuk mjaftojnë më për ta vlerësuar cilësinë e demokracisë nëse nuk ndiqen me qëndrueshmëri institucionale. Bllokimet e shpeshta paszgjedhore kanë ndryshuar mënyrën se si vendi perceptohet ndërkombëtarisht, duke zhvendosur fokusin nga procesi zgjedhor te kapaciteti për qeverisje.

Më 7 qershor Kosova shkon në zgjedhjet e treta parlamentare brenda 18 muajve - një ritëm që e largon ciklin zgjedhor nga normaliteti demokratik dhe e vendos atë në logjikën e krizës së përsëritur.

Vetëm gjashtë muaj më parë zgjedhjet prodhuan një fitues të qartë - Lëvizjen Vetëvendosje me mbi 51 për qind të votave - që në kushte normale do të nënkuptonte stabilitet politik. Por, dështimi për ta zgjedhur presidentin e ri të shtetit aktivizoi afatet kushtetuese dhe e ktheu vendin sërish në kutitë e votimit. Fushata është tashmë në lëvizje të plotë - me tubime, takime, fjalime - por përmbajtja e saj mbetet e kufizuar: më shumë akuza dhe kërkim përgjegjësish për atë që ka ndodhur dhe më pak ide të reja për zgjidhje apo rrugë përpara. "Ne nuk kemi pasur nevojë edhe për një fitore, por blloku opozitar ka pasur nevojë edhe për një humbje", ka thënë kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, tani kryeministër në detyrë, para disa mbështetësve të tij. "Ata që kishin mundësinë dhe

përgjegjësinë për të udhëhequr, zgjedhën të mos veprojnë", sipas një video-mesazhi të publikuar në "Facebook" nga kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza.

E "a do ta lëmë Kosovën të lodhet nga përçarjet dhe nga krizat e njëpasnjëshme, siç duan të tjerët?", ka pyetur bartësja e listës së Lidhjes Demokratike të Kosovës, Vjosa Osmani.

Mbi 2 milionë qytetarë me të drejtë vote do të mund ta japin përgjigjen në fletëvotime, por për vëzhguesit ndërkombëtarë të zhvillimeve në Kosovë pritshmëria shkon përtej pjesëmarrjes në zgjedhje.

Ish-i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për Kosovën, Wolfgang Petritsch, thotë se, mes pasigurish të mëdha globale, është koha që votuesit të sillen si qytetarë aktivë dhe kërkuar, duke i



dërguar mesazh të qartë udhëheqjes politike se bllokimet e zgjatura institucionale nuk janë më të pranueshme dhe se institucionet duhet të funksionojnë. "Unë nuk dua të përfshihem në politikën e brendshme dhe nuk e di se si do të zhvillohen zgjedhjet e ardhshme, por, në njëfarë mënyre, qytetarët duhet t'i thonë partisë dominuese dhe liderit të saj: Tani është koha të veproni, bëni diçka", thotë Petritsch për programin Expose të "Radios Evropa e Lirë". Ish-diplomati austriak shton se zgjedhjet e shpeshta, rivalitetet personale dhe mungesa e

kompromisit po e lënë Kosovën jashtë një momenti kyç, teksa po riformësohet arkitektura e sigurisë dhe politikës në Evropë, mes luftës në Ukrainë, tronditjeve në Lindjen e Mesme dhe dobësimit të garancive amerikane. Sipas tij, në vend që të shfaqet si një demokraci e vogël, por e besueshme, Kosova po perceptohet si një pikë shtesë paqëndrueshmërie në skajin e Evropës.

Ai thotë se 18 muaj pa qëndrueshmëri institucionale janë tepër për një shtet me siguri të brishtë si Kosova dhe paralajmëron se kjo situatë u jep

# KOMF-i, SUBJEKTEVE POLITIKE: SHMANGNI ÇDO FORMË TË PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE NË AKTIVITETET E FUSHATËS ZGJEDHORE

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Raportimet nga terreni gjatë ditëve të fundit tregojnë që fëmijët po përfshihen dhe përdoren nga subjektet politike për promovimin e aktiviteteve dhe mesazheve të tyre politike. Nisur nga kjo situatë, KOMF-i u bënë thirrje të gjitha subjekteve politike që t'i respektojnë të drejtat e fëmijëve dhe të shmangin çdo formë të përfshirjes së tyre në aktivitetet e fushatës zgjedhore. "Shfrytëzimi i fëmijëve për qëllime politike përbën shkelje të të drejtave të tyre, cenon mirëqenien e tyre dhe nuk është në interesin më të mirë të fëmijës. KOMF i bënë thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të monitorojë aktivitetet e subjekteve politike dhe, në çdo rast kur konstatohet përfshirja ose shfrytëzimi i fëmijëve në fushatë zgjedhore,

të ndërmarrë veprimet dhe masat përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi", thuhet në reagimin e KOMF-it. Njëkohësisht, KOMF-i u bënë thirrje prindërve që të mos i ekspozojnë fëmijët ndaj aktiviteteve politike dhe të mos i përfshijnë ata në asnjë formë në fushatat elektorale, përfshirë pjesëmarrjen në tubime, aktivitete promovuese apo ngjarje të organizuara nga partitë politike. "Po ashtu, KOMF fton mediat që mbulojnë procesin zgjedhor të luajnë një rol aktiv në monitorimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve gjatë fushatës dhe të raportojnë rastet e përfshirjes së tyre për qëllime politike, duke garantuar në çdo rast mbrojtjen e identitetit, privatësisë dhe dinjitetit të fëmijës", është theksuar në reagimin e KOMF-it.



argumente të tjera pesë shteteve të BE-së që nuk e njohin ende pavarësinë e saj, për t'i kthyer rezervat e tyre të mëparshme në një pretendim më bindës se Kosova nuk funksionon dot si shtet i plotë. "Çfarë të njohim? Që një vit e gjysmë nuk mund të kenë qeveri stabile, nuk mund të zgjedhin president... Pra, bëhet fjalë për një humbje dramatike të besimit se Kosova po përpriqet të jetë dhe të bëhet një shtet serioz", thotë Petritsch.

Bashkimi Evropian, si tërësi, pa u përfshirë drejtpërdrejt në procesin zgjedhor, ka reaguar disa herë ndaj bllokadave, duke kërkuar formimin e institucioneve dhe daljen nga ngërçi politik. Gjatë një vizite në Prishtinë në mes të majit, komisionarja për Zgjerim e BE-së, Marta Kos, u ka bërë thirrje forcave politike të gjejnë gjuhë të përbashkët për të ndërtuar institucione të qëndrueshme, në mënyrë që vendi të mund të ecë përpara në rrugën drejt bllokut evropian. Edhe Departamenti Amerikan i Shtetit ka vlerësuar se bllokimi i vazhdueshëm politik dëmton besimin në institucionet e Kosovës. Në një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë", më herët këtë muaj, një zëdhënës ka thënë se pret që të gjitha forcat politike të bashkëpunojnë për interesin më të mirë të qytetarëve të Kosovës. Javën e kaluar, Departamenti i Shtetit i ka ofruar Kongresit edhe raportin e vet të parë për Ballkanin Perëndimor, si obligim i ri ligjor ndaj të ashtuquajturit Ligj për Demokraci dhe Prosperitet të Ballkanit Perëndimor - ku përfshihet edhe Kosova. Raporti thekson se koha kur SHBA-ja ka udhëhequr proceset e ndërtimit të shteteve, ka përfunduar. "Administrata është e fokusuar në fuqizimin e aktorëve lokalë për t'i zgjidhur vetë sfidat e tyre, pa u mbështetur tepër te ndërhyrja



apo mbikëqyrja ndërkombëtare. Shtetet e Bashkuara janë të gatshme të ofrojnë mbështetje aty ku përfshirja e tyre kërkohet dhe kur u shërben interesave të tyre", thuhet në raport. Dokumenti thekson, po ashtu, se SHBA-ja vazhdon të marrë pjesë në misionin e NATO-s në Kosovë, që mbetet thelbësor për sigurinë dhe lirinë e lëvizjes, si dhe të mbështesë transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në një forcë profesionale të mbrojtjes territoriale. Lisa Homel, drejtoreshë e Qendrës për Evropë në Këshillin Atlantik, e konsideron këtë si një "sinjal domethënës" se SHBA-ja po vazhdon angazhimin e saj me Kosovën. Ndaj, Kosova "duhet të veprojë si një aleate e përgjegjshme dhe proaktive, për ta ruajtur këtë mbështetje". "Nëse do të jepja një këshillë, do të ishte kjo: të shihet më gjerë situata dhe të lihen mënjanë mosmarrëveshjet e brendshme, bllokadat dhe debatet e vazhdueshme. Të mendohet për atë që i sjell përfitim rajonit dhe popullsisë në pesë apo dhjetë vjetet e ardhshme, e që unë besoj fort se është integrimi euroatlantik dhe përafrimi me institucionet e BE-së, në veçanti", thotë Homel për Exposedën.

Ajo shton se pezullimi i Dialogut Strategjik vitin e kaluar, ka treguar se durimi i SHBA-së me politika të papërgjegjshme të Qeverisë së Kosovës shteron, ndonëse angazhimet për siguri mbeten të pandryshuara. Sipas saj, reformat nuk duhet parë vetëm si mjet për integrim të afërt në BE, por si vlerë në vetvete. Si shembull paralajmërues përmend Maqedoninë e Veriut, e cila - dikur një histori sukcesi - është bllokuar nga mosmarrëveshjet dhe ngërçet e brendshme politike. "Kosova ka ambicie për t'u anëtarësuar në BE dhe në NATO, por ende ka pesë shtete të BE-së që nuk e njohin dhe

dialogu me Serbinë është i bllokuar. Në këtë situatë, vendi nuk e ka luksin të mbetet i ngërthyer në kriza të brendshme politike, pasi ato e pengojnë përpunimin, si dhe aftësinë e tij për të mbrojtur interesat e qytetarëve dhe për të nxitur zhvillimin dhe rritjen ekonomike", thotë Homel. Të dy njohësit theksojnë se, në kontekstin e paqëndrueshmërisë globale, shembjes së rendit liberal të pas Luftës së Dytë Botërore dhe përqendrimin në siguri në Evropë, Kosova duhet të shfrytëzojë çdo hapësirë për të ecur përpara - sidomos në dialogun me Serbinë, që vazhdon ta bllokoi në shumë fronte - në mënyrë që, kur të ndryshojë klima politike ndërkombëtare, të mund të dëshmojë se ka bërë pjesën e saj. Petritsch është i qartë se zgjidhja e kontestit me Serbinë nuk është çështje "fitoreje" apo "humbjeje" ndaj serbëve, por domosdoshmëri për përmirësimin e jetës së përditshme dhe forcimin e shtetësisë për qytetarët e Kosovës. "Politika ka përgjegjësinë absolute të punojë për një zgjidhje dhe kjo kërkon edhe guxim. Nuk mund të këmbëngulësh vetëm në parime - 'serbët janë të këqij sepse na kanë vrarë'. Kjo është e qartë, por

politika ka të bëjë me të ardhmen. E kaluar nuk duhet harruar, por duhet mësuar prej saj dhe të bëhet diçka që krijon një të ardhme më të mirë për njerëzit tuaj", thotë Petritsch. Vëzhguesit, si vendorë ashtu edhe ndërkombëtarë, i konsiderojnë zgjedhjet si një nga elementet më të konsoliduara të sistemit politik në Kosovë. Në vlerësimet e tyre, ato përshkruhen si konkurrese dhe në përputhje me standardet bazë demokratike, me transferim paqësor të pushtetit dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve. Megjithatë, në disa raste është bërë edhe krahasimi me Bullgarinë, e cila në pesë vjetet e fundit ka kaluar nëpër shtatë cikle të njëpasnjëshme zgjedhore, pa arritur të prodhojë stabilitet institucional. Homel e përmbledh këtë ngërç edhe si mungesë përgjegjësie ndaj votuesve: vullneti i qytetarëve merr kuptim vetëm kur të zgjedhurit arrijnë të ndërtojnë institucione funksionale... "e, kjo kërkon kompromis e lëshim pe". "Njerëzit tashmë janë të pakënaqur, por kur të kuptohet më qartë kostoja e mbetjes prapa, mund të ketë më shumë presion dhe lëvizje sesa deri tani", thotë ajo. Nga perspektiva e politikave të BE-së, Petritsch e sheh edhe diasporën e Kosovës si një aset strategjik, pasi, siç thotë ai, ajo funksionon me sukses brenda sistemeve të sundimit të ligjit në BE, ndërsa vendi i origjinës mbetet i bllokuar nga mungesa e përgjegjësisë dhe kompromisit politik. Ai i nxit ata që do të votojnë më 7 qershor që t'i dërgojnë mesazh të qartë udhëheqjes politike për të vepruar. Vetëm në këtë mënyrë diaspora mund të sjellë standarde evropiane të llogaridhënies në politikën e Kosovës dhe ta afrojë vendin më bindshëm me BE-në, përfundon Petritsch.



# HOTI: PËR PESË VJET NUK ËSHTË BËRË ASGJË KONKRETE PËR HEKURUDHËN PRISHTINË - DURRËS

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Kandidati për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Abdullah Hoti, ka kritikuar qeverinë Kurti për, siç ka thënë ai, braktisjen e integritit kombëtar me Shqipërinë dhe mungesën e bashkëpunimit konkret ndërmjet dy vendeve. "Përveç dëmtimit të marrëdhënieve me aleatin kryesor strategjik të Kosovës, qeveria Kurti ka braktisur edhe integritimin kombëtar me Shqipërinë. Ka tri vjet që nuk mbahet asnjë mbledhje e përbashkët mes dy qeverive, duke bllokuar mekanizmin konkret për adresimin e çështjeve në bashkëpunim mes dy vendeve. Për pasojë, ka ngecur integrimi ekonomik, arsimor, kulturor dhe shëndetësor. Potenciali i madh që ekziston mes Kosovës dhe Shqipërisë po mbetet i pashfrytëzuar për shkak të mungesës së vullnetit politik. Në energji, është harruar projekti i përbashkët hidroenergjetik që do

të mundësonte një sistem të integruar energjetik, duke kombinuar potencialin hidroenergjetik të Shqipërisë me kapacitetet energjetike të Kosovës. Në bujqësi, nuk është bërë asnjë hap serioz drejt krijimit të një tregu të përbashkët dhe koordinimit të prodhimit sipas përparësive klimatike dhe ekonomike të secilit vend", ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se në turizëm nuk ka asnjë strategji për ta lidhur turizmin bregdetar të Shqipërisë me turizmin malor dhe rural të Kosovës, megjithëse ky do të ishte një nga produktet turistike më tërheqëse në rajon. "Në arsim lëvizshmëria e studentëve dhe stafit akademik mbetet minimale, ndërsa projektet e përbashkëta shkencore pothuajse nuk ekzistojnë. Në kulturë, është braktisur plotësisht agjenda e përbashkët kulturore shqiptare, e cila duhej jo vetëm të vazhdonte, por të zgjerohej edhe me

shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, Luginën e Preshevës dhe Malin e Zi. Dështimi më i dukshëm mbetet infrastruktura strategjike. Për pesë vite me radhë, Qeveria Kurti ka folur për hekurudhën Prishtinë-Durrës si një projekt madhor kombëtar. Pas pesë vitesh qeverisje, nuk ka asgjë konkrete. Nuk është vendosur asnjë metër binar. Projekti vazhdon të mbetet vetëm në deklarata dhe prezantime. Ironia është se ndërsa dje në Vushtri Kurti promovonte projekte të reja hekurudhore brenda Kosovës, hekurudha më e rëndësishme për lidhjen e Kosovës me Shqipërinë vazhdon të ekzistojë vetëm në fjalime", ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se në vend të bashkëpunimit Kurti ka zgjedhur të përfshihet në procese zgjedhore jashtë Kosovës. "Në Maqedoninë e Veriut kjo qasje kontribuoi në përçarjen e faktorit politik shqiptar, ndërsa në Shqipëri u përfshi në garën e



brendshme politike. Kjo nuk i shërben unitetit kombëtar, por thëllon ndarjet mes shqiptarëve. Qeveria e ardhshme duhet t'i rikthehet urgjentisht bashkëpunimit të politikave dhe projekteve me Shqipërinë. Duhet të rikthehen mbledhjet e përbashkëta të qeverive, të intensifikohet bashkëpunimi në të gjitha fushat dhe të avancohet themelimi i Asamblesë

Parlamentare Mbarëshqiptare, si forum i përhershëm për trajtimin e çështjeve strategjike kombëtare. Integrimi kombëtar nuk ndërtohet me slogane patriotike, konferenca për shtyp dhe postime në rrjete sociale. Ai ndërtohet me projekte konkrete, me institucione funksionale dhe me rezultate të matshme. Pikërisht këto kanë munguar gjatë këtyre pesë viteve", ka thënë Hoti.

## NË UASHINGTON DISKUTOHET NJOHJA E KOSOVËS NGA GREQIA

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Këshilli për Marrëdhënie Shqiptaro-Amerikane (AARC) ka zhvilluar një takim me kongresisten amerikane me prejardhje greke, Nicole Malliotakis, me të cilën ka diskutuar një sërë çështjesh që lidhen me Ballkanin Perëndimor dhe komunitetin shqiptaro-amerikan.

Lajmi është bërë me dije nga presidenti i AARC-së, Martin Vulaj, i cili ka njoftuar se gjatë takimit është vënë theksi te rëndësia e forcimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Greqisë, si dhe nevoja për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve, me synimin për ta arritur njohjen formale të Kosovës nga Greqia. "Një nga temat kryesore të diskutimit ishte forcimi i marrëdhënieve mes Greqisë dhe Kosovës dhe inkurajimi i bashkëpunimit më të ngushtë që në të ardhmen mund të çojë drejt njohjes zyrtare të Kosovës



nga Greqia", është thënë në njoftimin e AARC-së.

Përfaqësuesit e organizatës paraqitën shqetësimet lidhur me të drejtat dhe statusin e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, duke nënvizuar rëndësinë e angazhimit të

vazhdueshëm amerikan dhe monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes Kornizë e Ohrit. Në takim është diskutuar edhe lëvizja studentore në vend dhe kërkesat e saj për llogaridhënie institucionale. Sipas njoftimit, kongresistja Malliotakis ka

shfaqur interes të veçantë për zhvillimet rajonale, duke parashtruar pyetje rreth vendeve më pro-amerikane në Ballkan, ndikimit rus dhe kinez, si dhe mënyrës se si Serbia ushtron ndikimin e saj në rajon. "Ne theksuam se Kosova mbetet një

nga shoqëritë më pro-amerikane në botë, ndërsa Shqipëria dhe komunitetet shqiptare në Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi kanë dëshmuar vazhdimisht mbështetje të fortë për Shtetet e Bashkuara dhe aleancën transatlantike", është thënë në njoftimin e AARC-së.

Përfaqësuesit e AARC-së kanë diskutuar edhe përpjekjet e Serbisë për të ushtruar ndikim politik, ekonomik, mediatic dhe të sigurisë në vende të ndryshme të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën.

Delegacioni i AARC-së në këtë takim është udhëhequr nga kryetari Eli Rusi dhe përfshinte nënkryetarin Tony Marke, sekretarin Burim Rexhaj, anëtarët e bordit Agim Jusufi dhe Vehbi Bajrami, si dhe mbështetës të tjerë të organizatës.

## ZKA-ja dhuron pajisje teknologjike dhe inventar për pesë shkolla

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me drejtorët e pesë institucioneve arsimore për dorëzimin e inventarit dhe pajisjeve teknologjike të liruara nga përdorimi në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) me qëllim të mbështetjes së shkollave dhe procesit mësimor.

Gjatë nënshkrimit të marrëveshjeve, auditorja e përgjithshme Vlora Spanca theksoi se përmes këtij aktiviteti ZKA synon t'i ndihmojë institucionet

arsimore si dhe pasuritë publike të përdoren sa më mirë.

Pajisjet e dorëzuara përfshijnë pajisje teknologjike, inventar si dhe materiale të tjera për nevojat e institucioneve arsimore në përputhje me kërkesat e tyre.

Shkollat përfituese nga kjo iniciativë janë ShML "Ahmet Gashi" në Prishtinë, ShFMU "Mehmet Gjevari" në Prishtinë, ShFMU "Naim Frashëri" në Prishtinë, ShFMU "28 Nëntori" në Bresanë të Dragashit, si dhe shkolla "Ilir Konushevci" në Llugë të

Podujevës.

Sipas marrëveshjeve, pronësia e pajisjeve kalon te shkollat përfituese pas procesit të pranim-dorëzimit dhe evidentimit përkatës, ndërsa institucionet përfituese marrin përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe përdorimin e tyre sipas destinimit të përcaktuar. "Zyra Kombëtare e Auditimit mbetet e përkushtuar që resurset publike të menaxhohen me përgjegjësi, integritet dhe efikasitet. Në këtë frymë, një pjesë e pasurisë jofinanciare po vihet në shërbim të shkollave, me



bindjen se do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të punës dhe funksionimit të

përditshëm të institucioneve tona arsimore", tha auditorja e përgjithshme Vlora Spanca.

## Gjatë javës së fundit janë raportuar pesë raste të reja të fruthit

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë periudhës 16 prill deri më 1 qershor 2026 në Kosovë janë raportuar gjithsej 25 raste të konfirmuara të fruthit.

Gjatë javës së fundit janë raportuar pesë raste të reja.

Nga numri i përgjithshëm i rasteve sipas komunave janë raportuar: Ferizaj, Prishtinë (6), Kaçanik (5) dhe nga një rast në Deçan, Fushë-Kosovë, Gjiçan, Lipjan, Obiliq dhe Shtime.

IKShPK rekomandon që çdo person me simptoma të dyshimta të fruthit, si

temperaturë e lartë, skuqje apo ndryshime në lëkurë, kollë dhe rufë, të paraqitet menjëherë në institucionet më të afërta shëndetësore.

Duke pasur parasysh kontagjiozitetin e lartë të fruthit dhe rrezikun e përhapjes së tij në komunitet, IKShPK u bënë thirrje

prindërve dhe kujdestarëve që ta verifikojnë statusin e vaksinimit të fëmijëve të tyre dhe ta sigurojnë vaksinimin sipas kalendarit të rregullt të imunizimit në qendrat e mjekësisë familjare.

Vaksinimi mbetet masa më efektive dhe më e sigurt për parandalimin e fruthit dhe



mbrojtjen e individëve të pavaksinuar dhe ruajtjen e shëndetit publik.

## EDHE NË KOSOVË SHËNOHET DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Të hënën është shënuar 1 qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, një ditë që i kushtohet promovimit të të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve. Kjo ditë ka rrënjë në përpjekjet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, të forcuara pas miratimit të Deklaratës së të Drejtave të Fëmijëve në vitin 1959 dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës në vitin 1989 nga OKB. Megjithatë, të dhënat globale tregojnë se sfidat mbeten të mëdha. Dhjetëra miliona fëmijë vazhdojnë të mos kenë qasje në arsim, ndërsa miliona të tjerë përballen me varfëri ushqimore dhe kushte të vështira jetese. Po ashtu, qindra miliona vajza në mbarë botën janë përballur me martesë të hershme, një fenomen që cenon drejtpërdrejt të drejtat e tyre dhe zhvillimin e shëndetshëm. Këto statistika dëshmojnë se, pavarësisht progresit, nevojitet

angazhim i vazhdueshëm për të garantuar një të ardhme më të sigurt dhe më të drejtë për çdo fëmijë.

Me rastin e 1 qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, komuna e Prishtinës dhe ETEA kanë organizuar aktivitetin publik: "Përtej festës: Flasim për sigurinë e fëmijëve në shkollë". "Sot festojmë ata që i japin Kryeqytetit energji, ngjyra dhe jetë", ka thënë Rama.

Ndërkaq u. d. presidentja Albulena Haxhiu ka marrë pjesë në Konferencën e Nëntë të Shëndetit, Mirëqenies, Edukimit dhe të Drejtave të Fëmijëve. Ajo ka thënë se fëmijët kanë nevojë për 365 ditë vëmendje, mbrojtje dhe kujdes. "Kanë nevojë të dëgjohen me kohë, të ndihmohen pa vonesë dhe të rriten në shkollë, familje e komunitete ku ndihen të sigurt dhe të respektuar. Falënderova Qendrën për Hulumtime Psiko-



Sociale dhe Klinikën 'Empatia' për organizimin, si dhe të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët, shpesh larg vëmendjes

publike, por shumë afër nevojave reale të shoqërisë. Gëzuar 1 qershorin të gjithë fëmijëve. Sot ju urojmë ndërkaq

çdo ditë duhet t'ju dëgjojmë, t'ju mbrojmë dhe t'ju qëndrojmë pranë", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

## ZGJEDHJE TË REJA, PROGRAME TË VJETRA POLITIKE: KUSH PO E MASHTRON EKONOMINË E KOSOVËS?



PRISHTINË, 1 QERSHOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka theksuar se Kosova po hyn në një tjetër proces zgjedhor por, fatkeqësisht, me të njëjtat premtime, të njëjtat programe të ricikluara dhe të njëjtën mungesë vizioni për zhvillimin ekonomik të vendit. Ai ka thënë se shumica e partive politike po kërkojnë votën e qytetarëve pa u ofruar atyre një plan të qartë se si do të rritet prodhimi, eksporti, investimet dhe punësimi. "Po dëgjojmë premtime milionëshe e miliardëshe, por nuk po dëgjojmë asnjë shpjegim se ku do të gjenden paratë, kush do t'i

financojë ato dhe si do të realizohen. Kjo nuk është garë programesh, por garë premtimesh pa mbulesë. Më shqetësuese është se ekonomia, sektori privat, prodhuesit dhe eksportuesit pothuajse nuk ekzistojnë në debatimin politik. Asnjë vizion serioz për industrinë, asnjë strategji për eksportet, asnjë plan për të ndaluar largimin e fuqisë punëtore dhe asnjë platformë të qartë për tërheqjen e investimeve të huaja. Pas më shumë se 26 vitesh liri dhe mbi 18 vite shtet, është e papranueshme që partitë politike ende të mos kenë një projekt kombëtar ekonomik për

Kosovën. Një vend nuk zhvillohet me slogane, por me fabrika; nuk forcohet me propagandë, por me investime; nuk ecën përpara me premtime, por me rezultate", ka thënë Shahini, duke shtuar se qytetarët duhet t'i pyesin të gjithë kandidatët: Çfarë do të prodhoni? Çfarë do të eksportoni? Sa vende pune do të hapni? Sa investime do të sillni? Dhe si do ta bëni Kosovën më konkurruese dhe më të respektuar në botë? "Kosova nuk ka nevojë për politikë që flet shumë dhe prodhon pak. Kosova ka nevojë për leadership që premtion më pak, por realizon më shumë", ka thënë Shahini.

## Nga sot në Kosovë ndalohen pagesat mbi 2 000 euro me para të gatshme

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se duke filluar nga sot, pagesat në vlerë mbi 2 000 euro ndërmjet bizneseve dhe individëve nuk do të mund të

kryhen më me para të gatshme. Sipas njoftimit, të gjitha transaksionet që e kalojnë këtë shumë duhet të realizohen vetëm përmes sistemit bankar ose formave të tjera elektronike të pagesës.

"Nga 1 qershori 2026, pagesat mbi 2,000 euro ndërmjet bizneseve dhe individëve nuk lejohen të kryhen me para gatshme dhe duhet të realizohen vetëm përmes sistemit bankar ose formave

të tjera elektronike të pagesës. Respektoni kufizimin e përcaktuar me ligj dhe shmangni gjambat. Mos paguani cash mbi limitin e lejuar", thuhet në njoftimin e ATK-së.



## ZEKA: GAZI NGA SHBA-ja, VENDIMTAR PËR SIGURINË KOMBËTARE TË KOSOVËS

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Në kohën kur Shtetet e Bashkuara po rrisin praninë energjetike në Ballkanin Perëndimor, në Kosovë është rikthyer debati për furnizimin me gaz të lëngshëm natyror nga ShBA-ja.

Diskutimi vjen mes përpjekjeve të Uashingtonit për t'i diversifikuar burimet energjetike në rajon dhe nevojës së Kosovës për të siguruar stabilitet afatgjatë në sektorin e energjisë.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka paraqitur tashmë një dokument i cili trajton çështjen e gazit të lëngshëm natyror nga ShBA-ja në Evropë dhe potencialin e tij për Kosovën.

Drejtori ekzekutiv i kësaj ode, Arian Zeka, vlerëson në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" se gazi amerikan mund të luajë rol kyç në forcimin e sigurisë energjetike të Kosovës, duke theksuar se siguria energjetike sot është e barasvlershme me sigurinë kombëtare.

Në kontekstin e zhvillimeve globale, përfshirë konfliktet, çrregullimet në zinxhirët e

furnizimit dhe luhatjet e çmimeve, ai thotë se është e domosdoshme që Kosova t'i kthehet seriozisht çështjes së gazit.

Një alternativë e tillë, sipas tij, do ta ndihmonte vendin ta ulë varësinë nga importi i energjisë elektrike dhe të sigurojë stabilitet më të madh në çmimet e rrymës. Por, Zeka e konsideron shqetësuese mungesën e një qëndrimi të qartë institucional për përfshirjen e Kosovës në rrjetet rajonale të gazit. "Gjithçka varet nga vullneti politik. Ndoshta jemi pak mbrapa në aspektin e legjislacionit ose të infrastrukturës ligjore. Financimi mund të sigurohet lehtë për këtë projekt. Prandaj, mungesa e qartë e një zotimi të qeverisë, se Kosova do të bëhet pjesë e një infrastrukture të tillë, është pak paradoksale", thotë Zeka.

Ai thekson se nga investitorët amerikanë ka interesim dhe gatishmëri konkrete për të investuar në sektorin energjetik në Kosovë.

Ambasada Amerikane në



Prishtinë, përmes një postimi në "Facebook" më 28 maj, theksoi se "Shtetet e Bashkuara janë të gatshme për të bashkëpunuar me Kosovën në avancimin e zgjidhjeve energjetike të sigurta dhe të diversifikuara si dhe për të tërhequr investime të ardhshme". Në vitin 2021 Kosova hoqi dorë nga projekti për ndërtimin e infrastrukturës së gazit, i financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit e ShBA-së. Atëkohë ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, tha se

"nevojiten më shumë informacione për të qenë të sigurt se ndërtimi i infrastrukturës së gazit është opsioni më i mirë për tranzicionin energjetik". Por, në Samitin Trans-Atlantik për Sigurinë e Gazit, të mbajtur në shkurt në Uashington, Rizvanolli, tani ministere në detyrë, shprehu gatishmërinë e Kosovës për t'u furnizuar me gaz natyror nga ShBA-ja, duke e cilësuar këtë bashkëpunim si vendimtar për ndërtimin e një sektori të sigurt energjetik.

Në fillim të këtij muaji, "Radio Evropa e Lirë" i është drejtuar Ministrisë së Ekonomisë me pyetje lidhur me planet konkrete për lidhjen me rrjetin rajonal të gazit, ndërtimin e infrastrukturës përkatëse dhe bisedimet me palën amerikane, por nuk ka marrë përgjigje.

Gjatë javëve të fundit ShBA-ja dhe kompani amerikane kanë nënshkruar marrëveshje miliardëshe me disa vende të Ballkanit Perëndimor për projekte energjetike në rajon.

Kosova, megjithatë, ka mbetur jashtë kësaj vale investimesh.

I dërguari i posaçëm i Departamentit Amerikan të Energjisë, Joshua Volz, ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" se sistemi energjetik i Kosovës ka nevojë urgjente për modernizim - çfarë krijon mundësi të mëdha për industrinë amerikane që të investojë. Megjithatë, ai ka theksuar se projektet e mëdha do të varen nga vetë Kosova, përkatësisht përmirësimi i mjedisit biznesor dhe rregullator në vend.

## BQK-ja MIRATON PASQYRAT FINANCIARE VJETORE DHE NDAN 12 MILIONË EURO PËR BUXHETIN E SHTETIT PËR VITIN E TRETË RADHAZI

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka miratuar pasqyrat financiare vjetore të BQK-së për vitin financiar 2025, të audituara nga auditori i jashtëm i pavarur.

Pasqyrat financiare vjetore kanë marrë opinion të pastër (pa kualifikim) nga auditori i jashtëm, duke konfirmuar se ato paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare dhe performancën financiare të Bankës Qendrore, në përputhje me kornizën përkatëse të raportimit financiar.

Për vitin financiar 2025 BQK ka realizuar të ardhura neto në vlerë prej 24 milionë eurosh. Në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të

Republikës së Kosovës (nenin 55, si dhe nenin 56, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2), 50 për qind e të ardhurave të ndashme transferohen në si të hyra për buxhetin e shtetit, ndërsa 50 për qind alokohen në fondin e rezervave të përgjithshme të Bankës Qendrore.

Në bazë të këtyre dispozitave, 12 milionë euro nga të ardhurat e ndashme për vitin 2025 do të transferohen në buxhetin e shtetit, ndërsa pjesa tjetër do të alokohet në rezervat e përgjithshme të BQK-së, në përputhje me kërkesat ligjore dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare institucionale. Ky është viti i tretë radhazi që Banka Qendrore e Republikës së



Kosovës ndan të ardhura për buxhetin e shtetit, duke e çuar vlerën totale të transferimeve në afër 38 milionë euro.

Miratimi i pasqyrave financiare me opinion të pastër nga auditori i jashtëm dhe ndarja e të ardhurave për buxhetin e shtetit

reflektojnë forcimin e mëtejshëm të qeverisjes institucionale, administrimit financiar, transparencës dhe llogaridhënies së BQK-së, në përputhje me mandatin e saj ligjor.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të vazhdojë t'i ushtrojë funksionet e saj në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të kujdesshme, duke ruajtur stabilitetin financiar, integritetin e sistemit financiar dhe qëndrueshmërinë afatgjatë institucionale.

Pasqyrat financiare vjetore, së bashku me raportin e auditorit të jashtëm, do të publikohen dhe dorëzohen në pajtim me kërkesat ligjore për raportim dhe transparencë.

## Pagat në Kosovë u rritën mbi 15 %, sektori privat mbetet me pagat më të ulëta

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Nivelin e Pagave në Kosovë, 2025", i cili paraqet të dhëna mbi pagën mesatare bruto dhe neto sipas sektorit publik (administrata), ndërmarrjeve publike, sektorit privat dhe aktiviteteve ekonomike.

Në vitin 2025 paga mesatare bruto në Kosovë ishte 713 euro, krahasuar me 639 euro në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 11,6 %.

Ndërkaq paga mesatare neto arriti në 636 euro, nga 552 euro sa ishte në vitin 2024, duke

shënuar një rritje prej 15,2 %. Në sektorin publik (administrata), paga mesatare bruto u rrit nga 755 euro në 840 euro, ose për 11,3 %, ndërsa paga mesatare neto u rrit nga 668 euro në 744 euro, ose për 11,4 %.

Në ndërmarrjet publike, paga mesatare bruto u rrit nga 783 euro në 915 euro, duke shënuar rritje prej 16,8 %, ndërsa paga mesatare neto u rrit nga 685 euro në 812 euro, ose për 18,5 %. Në sektorin privat, paga mesatare bruto u rrit nga 598 euro në vitin 2024 në 666 euro në vitin 2025, duke shënuar një

rritje prej 11,4 %, ndërsa paga mesatare neto u rrit nga 513 euro në 596 euro, ose për 16,2 %. Niveli i pagave më të larta në Kosovë ishte sektori i ndërmarrjeve publike, derisa me paga më të ulëta ishte sektori privat.

Në vitin 2025 aktiviteti ekonomik me nivelin më të lartë të pagës mesatare, si bruto ashtu edhe neto, ishte "Informim dhe komunikim", me 1 216 euro bruto dhe 1,068 euro neto. Pas tij renditet aktiviteti "Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar", me 1 133 euro



bruto dhe 1 000 euro neto. Në anën tjetër, niveli më i ulët i pagave u regjistrua në

aktivitetin "Shërbime të tjera", me 425 euro bruto dhe 387 euro neto.

# IZRAELI FORCON KUFIJTË NË LINDJEN E MESME, ZHVENDOS EDHE ATA TË DIPLOMACISË

Tiro ekziston prej pesë mijë vitesh. Është një qytet fenikas në Mesdhe, pasuri e UNESCO-s, një nga ato vende që njerëzimi ka vendosur kolektivisht ta konsiderojë të pazëvendësueshme, të papërsëritshme, të denjë për t'i mbijetuar luftërave.

Të mërkurën e kaluar, ushtria izraelite urdhëroi evakuimin e të gjithë qytetit dhe zonave përreth, dyqind mijë banorë, me dy orë kohë për t'u larguar, para se të fillonin bombardimet.

Ali Sleiman, peshkatar, vendosi të qëndronte në breg të detit me shufrat e tij të peshkimit. Ai ishte i bindur se cepi i tij i qytetit, shtëpitë e ulëta pranë kampit të refugjatëve palestinez El-Buss, nuk mund të ishte objektiv. Nuk ishin as fqinjët e tij, nuk ishin as familjet tashmë të zhvendosura që kishin gjetur strehim aty.

Bombardimet ranë pranë rrënojave të lashta, kështjella mesjetare e Beaufort mbi Nabatiye u godit drejtpërdrejt, dhe vendi shumë-fetar i Shamaa-s (që ndodhet dhjetë kilometra nga Tiro) humbi të paktën tre nga katër kupolat e tij.

Ministri i Kulturës së Libanit, Ghassan Salame, i kërkoi UNESCO-s të emërojë një komisar të posaçëm dhe shtoi, me një saktësi që vlen më shumë se një komunikatë e gjatë: Libani i kishte shënuar të gjitha vendet e trashëgimisë botërore me simbole të posaçme, "por mesa duket forca ajrore izraelite nuk e respekton shumë këtë identifikim".

Që nga 17 prilli, dita kur armëpushimi hyri formalisht në fuqi, të paktën 3 mijë e 355 persona janë vrarë dhe 10 mijë e 95 janë plagosur në territorin libanez. Këto janë të dhëna të Ministrisë së Shëndetësisë në Bejrut, të mbledhura nga spitalet që ende funksionojnë, nga ato që ende kanë hapësirë në korridore për të mbajtur shënime. Vetëm gjatë javës së fundit, sipas UNICEF-it, 77 fëmijë janë vrarë ose plagosur. Të dielën në mëngjes, IDF lëshoi urdhrin më të madh të evakuimit që nga fillimi i armëpushimit: të gjitha zonat në jug të lumit Zahrani, rreth dyzet kilometra nga kufiri izraelit, u shpallën "zona luftimi", me thirrjen që banorët të zhvendosen në veri të lumit. Urdhri mbulon rreth 14% të territorit libanez dhe i shtohet një serie që në javët e fundit ka prodhuar, sipas vetë IDF-së, nëntë urdhra evakuimi vetëm brenda 24 orëve paraprake.



Zëdhënësi ushtarak sqaroi se çdo strukturë e konsideruar e përdorur për qëllime ushtarake mund të trajtohet si objektiv i ligjshëm dhe se urdhri i evakuimit zgjeron lirinë e veprimit të forcave izraelite si në terren ashtu edhe nga ajri. Një fjali që duhet lexuar për atë që është: evakuimi nuk është masë mbrojtjeje për civilët. Është masë për liri operacionale të ushtrisë. Njerëzve u urdhërohet të largohen sepse, pasi largohen, gjithçka që mbetet është objektiv.

Mekanizmi është gjithmonë i njëjtë: një urdhër në Telegram, pastaj sulme ajrore, pastaj buldozerë. Më shumë se pesëdhjetë fshatra në jug të Libanit janë shkatërruar tashmë me ekskavatorë, në një fushatë sistematike të dokumentuar nga imazhet satelitore që vazhdon pothuajse çdo ditë.

Fshatrat në zonën e vetëshpallur tampon nuk ekzistojnë më si të tillë, por janë vargje rrënojash. Të zhvendosurve nuk u lejohet të kthehen dhe 110 lokalitete mbeten subjekt i urdhrave të zhvendosjes së detyruar izraelite, përfshirë 55 qendra të banuara nën vijën e re të demarkacionit.

Këtë javë, linja është

zhvendosur sërish. Forcat izraelite po avancojnë në veri të lumit Litani, në juglindje të Nabatiyes, qyteti i dytë më i madh në Libanin jugor. Litani ishte paraqitur tashmë si kufiri natyror i zonës tampon, kufiri përtej të cilit Izraeli ishte zotuar, të paktën formalisht, të mos shkonte më tej. Tani është kaluar, pa negociata, pa marrëveshje, me dekret ushtarak të njëanshëm.

Një avancim që vendoset në kontekstin më të gjerë rajonal që i ka hapur Netanyahu një dritare që vlen më shumë se çdo marrëveshje diplomatike: mundësinë për të rishkruar kufirin verior të Izraelit në mungesë të një pengese iraniane, para se negociatat me Teheranin të përfundojnë dhe para se komuniteti ndërkombëtar të rifitojë vëmendjen.

Buldozerët punojnë shpejt dhe hartat përditësohen çdo javë. Strategjia që del prej kësaj konsiston në krijimin e një pranie territoriale aq të konsoliduar sa çdo marrëveshje e ardhshme diplomatike të detyrohet të nisë nga ajo prani si fakt i kryer. Pushtimi izraelit tashmë mbulon 15% të territorit libanez, dhe ofensiva e fundit ka shkaktuar zhvendosjen e 20% të popullsisë së vendit.

Nuk bëhet fjalë për një zonë tampon në kuptimin teknik të termit. Një brez territori i kontrolluar përkohësisht për arsye sigurie, por për një pushtim strukturor që zgjerohet shtesë pas shtrese.

Më shumë se 822 mijë persona, përfshirë gati 300 mijë fëmijë, janë regjistruar si të zhvendosur. Rreth 128 mijë jetojnë në qendra kolektive në të gjithë vendin. Strehimet në Tiro janë tashmë të mbingarkuara, me familjet e zhvendosura që lëvizin gjithnjë e më shumë drejt veriut. Në veri të Tiros, pastaj në veri të Litanit, tani në veri të Zahranit. Çdo urdhër evakuimi e zhvendos vijën e sigurisë së perceptuar 40 kilometra më lart, drejt Bejrutit, drejt qendrës së vendit. Por Bejruti është goditur tashmë të enjten e kaluar për herë të parë në tre javë, dhe një zyrtar i lartë izraelit ka sqaruar se sulmet e synuara mbi kryeqytetin nuk janë të kufizuara nga asnjë kusht i vendosur nga Uashingtoni.

Që nga fillimi i armëpushimit, 15 sulme kanë goditur struktura shëndetësore, duke vrarë 12 punonjës shëndetësorë dhe plagosur 21 të tjerë.

Ramzi Kaiss nga Human Rights Watch tha atë që deklaratat


zyrtare e thonë me shumë më tepër kujdes: "Qeveria izraelite jo vetëm që ka shkelur vazhdimisht ligjet e luftës, por vazhdon të deklarojë hapur synimin për të kryer mizori të mëtejshme. Dhe ia del ta bëjë këtë sepse mbi ushtrinë izraelite nuk ka asnjë frenë."

Frenat nuk ekzistojnë sepse ata që mund ta vendosin kanë zgjedhur të mos vendosin. Administrata Trump është e angazhuar në negociata me Teheranin dhe ka nevojë që Netanyahu të mbetet një aleat funksional, që do të thotë të tolerojë në jug të Libanit atë që thuhet se nuk dëshirohet të shihet në Bejrut.

Por dallimi mes jugut të Libanit dhe Bejrutit është pikërisht lloji i kufirit që kjo luftë tashmë e ka treguar se nuk e respekton. Netanyahu, ndërkohë, duhet të mbajë bashkë një koalicion të brendshëm gjithnjë e më të paqëndrueshëm: e djathta e qeverisë nuk do t'i falte ndërprerjen e operacioneve të perceptuar si dorëzim, ndërsa opozita e akuzon se nuk po bën mjaftueshëm për të mbrojtur komunitetet e Galilesë.

Lufta në Liban është gjithashtu, si gjithmonë, një luftë e brendshme e zhvilluar në një territor të huaj.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## “Dardanët” rikthehen në stërvitje

**PRISHTINË, 1 QERSHOR** - Pas ndeshjes miqësore në Pragë, Kombëtarja e Kosovës ka vazhduar përgatitjet për sfidën

e radhës kundër Andorrës. Në seancën stërvitore në stadiumin “Fadil Vokrri” kanë marrë pjesë 11 futbollistë,

ndërsa pjesa tjetër e ekipit ka zhvilluar program rigjenerues në hotel pas angazhimit në ndeshjen ndaj Çekisë, të cilën

Kosova e ka humbur 1:2. “Puna vazhdon me fokus maksimal drejt miqësore së dytë”, ka njoftuar FFK-ja.



## MALISHEVA NËNKAMPIONE, LLAPI MBETET NË BARAZH

**PRISHTINË, 1 QERSHOR** - Me ndeshjet e javës së 36 është mbyllur edicioni 2025/26 i Albi Mall Superligës së Kosovës, duke sjellë verdiktet përfundimtare të një sezoni tejet interesant dhe konkurrues. Malisheva ka realizuar suksesin më të madh në historinë e klubit, duke e përfunduar kampionatin në pozitën e dytë dhe duke u shpallur nënkampione e Kosovës për herë të parë. Skuadra nga Malisheva e ka vulosur këtë arritje me një fitore spektakolare ndaj kampiones Drita me rezultat 3:2. Edhe pse gjilanasit kanë

krijuar epërsi në pjesën e parë me golat e Oniks Grezdës dhe Mike Artur, vendasit reagojnë fuqishëm në vazhdim. Mevlan Zeka ishte figura kryesore e ndeshjes me dy gola të realizuar, ndërsa golin tjetër për Malishevën e shënoi Besnik Ferati. Në Klinë Dukagjini e ka mbyllur sezonin me fitore minimale ndaj Ballkanit. Golin e vetëm të takimit e ka realizuar Mërgim Pefqeli, duke i siguruar skuadrës tri pikët e fundit të këtij edicioni. Ndeshje me pesë gola është



zhvilluar në Gjilan, ku vendasit kanë triumfuar ndaj Prishtinës së Re me rezultat 3:2. Për Gjilanin kanë realizuar Armend Thaqi,

Blerind Morina dhe Senad Jaroviq, ndërsa te mysafirët golashënues ishin Rion Rushiti dhe Astrit Berisha. Fitore me peshë të madhe ka

siguruar edhe Drenica, e cila në stadiumin “Fadil Vokrri” ka mposhtur Prishtinën me rezultat 2:1. Albin Krasniqi ka realizuar për kryeqytetasit, derisa Igbal Jashari dhe Indrit Prodani kanë shënuar golat që i kanë siguruar skuadrës nga Skenderaj mbijetesën në elitë. Ndërka Llapi ka triumfuar ndaj Ferizajt me rezultat 3:2 por, pavarësisht prej tri pikëve të fituara, skuadra nga Podujeva nuk ka arritur ta shmangë barazhin dhe do ta kërkojë mbetjen në Superligë përmes ndeshjes shtesë kundër Dinamos.

## FC MITROVICA, KAMPIONE E LIGËS SË DYTË



**MITROVICË, 1 QERSHOR** - FC Mitrovica e ka mbyllur me sukses sezonin 2025/2026 duke fituar titullin e kampionit në Ligën e Dytë, njëherësh duke e siguruar inkuadrimin në Ligën e Parë. Në ndeshjen e fundit të luajtur në stadiumin “Xhevat Jusufi”, skuadra mitrovicase e ka

mposhtur Podujevën me rezultat 4:1. Tashmë ky qytet do t'i ketë tri skuadra në Ligën e Parë. Me këtë fitore klubi mitrovicas ka konfirmuar dominimin gjatë sezonit dhe rikthimin në një nivel më të lartë të garave në futbollin e Kosovës. Pas përfundimit të ndeshjes, trofeu i kampionit iu

dorëzua nga anëtarë të KE i FFK-së, Xhelal Broja, i cili në emër të Federatës së Futbollit të Kosovës e ka përgëzuar FC Mitrovicën për suksesin dhe inkuadrimin në Ligën e Parë, duke i uruar klubit suksese në sezonin e ri dhe vazhdimësi të rezultateve pozitive në gara.

## SHTATË KLUBE FITUAN MË SHUMË SE 100 MILIONË EURO NË LIGËN E KAMPIONËVE KËTË SEZON

Liga e Kampionëve, gara më prestigjioze e klubeve në botë, është mbyllur zyrtarisht dje me triumfin e Paris Saint-Germainit në finalen e madhe ndaj Arsenalit. Pas një ndeshjeje të fortë dhe të baraspeshuar, fituesi është përcaktuar nga gjuajtjet e penalltive, ku “Shenjtorët” janë treguar më të saktë dhe fituan 4-3, duke kurorëzuar sezonin me trofe. Përveç lavdisë sportive, ky edicion ka sjellë edhe përfitime të mëdha financiare, ndërsa logjikisht më së shumti arkëtuan klubet që shkuan më larg në garë.

Finalistët ishin edhe “fituesit” kryesorë në aspektin e të ardhurave. PSG-ja ka mbledhur gjithsej 145.9 milionë euro, ndërsa Arsenalit ka përfituar 143.2 milionë euro, shifra që pasqyrojnë rrugëtimin e gjatë deri në finale dhe bonuset e performancës. Pas tyre vijnë klubet që janë ndalur në fazat e avancuara, por sërish kanë siguruar shumën të konsiderueshme nga UEFA. Bayern Munichu është renditur i treti me 127.3 milionë euro, ndërsa Liverpooli ka arkëtuar 109.5 milionë euro. Më pas janë Atletico Madridi me 104.2

milionë euro dhe Real Madridi me 102.6 milionë euro, ndërsa lista e klubeve me përfitimin më të lartë në këtë edicion, sipas këtyre shifrave, përmbyllet me Barcelonën që ka fituar 100.3 milionë euro. Këto të ardhura përfshijnë shpërblimet për pjesëmarrje, rezultatet dhe kualifikimet në fazat e ndryshme të turneut, duke dëshmuar edhe një herë se Liga e Kampionëve nuk është vetëm trofe prestigji, por edhe burimi më i madh financiar në futbollin e klubeve, ku çdo hap i kaluar në garë rrit ndjeshëm arkëtimet sezonale.



## Kosova organizon për herë të parë Kampionatin Ballkanik të Çiklizmit

**PRISHTINË, 1 QERSHOR** - Federata e Çiklizmit e Kosovës do të mbajë nesër (e mërkurë) një konferencë për medie në prag të organizimit të BCU Kampionatit Ballkanik të

Çiklizmit 2026, ngjarje që për herë të parë zhvillohet në Kosovë. Konferenca do të mbahet nga ora 11:00, ku drejtuesit e federatës do të prezantojnë detaje lidhur me

organizimin e kampionatit, përgatitjet teknike dhe operative si dhe synimet e ekipit përfaqësues të Kosovës në këtë garë. Në Kampionatin Ballkanik të Çiklizmit 2026 do të marrin

pjesë përfaqësues nga 10 shtete të rajonit, ndërsa organizimi i kësaj ngjarjeje konsiderohet një moment i rëndësishëm për zhvillimin dhe promovimin e çiklizmit në vend.





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

**Datë: 02.06.2026**

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013) nenet 24 dhe 35, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024) nenet 21 dhe 33, nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Rregullores Nr.01/31/24 datë 31.01.2025 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë nenet 4,11, Këshilli Shkencor i Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë në mbledhjen e mbajtur më 01.06.2026 shpall:

### KONKURS

- Konkurse për zgjedhje/rizgjedhje për vendet e punës:
  - Këshilltar shkencor për periudhën bashkëkohore shek. XX.
  - Këshilltar shkencor për periudhën e historisë moderne shek. XVI-XIX.
  - Këshilltar shkencor për periudhën e antikës.

#### Kandidatët/ja për Këshilltar shkencor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencave.
- Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencorë për fushën (periudhën historike) që dëshmohet.
- Të ketë dy (2) vepra shkencore monografike, një pas zgjedhjes së fundit dhe dy (2) vëllime me dokumente, një pas zgjedhjes së fundit, nga periudha përkatëse, të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë dhe akademitë e shkencave.
- Më së paku pesë (5) punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante ndërkombëtare nga periudha përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit, dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.
- Të ketë pjesëmarrje aktive së paku në tri (3) konferenca, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare.
- Përvojë së paku në dy (2) projekte kërkimore-shkencore, të realizuara nga institucionet kërkimore-shkencore dhe profesionale.
- Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.

#### Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse.
- Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara sipas akteve në fuqi.
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj.
- CV-të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj).

Zgjedhja e personelit shkencor dhe hulumtues të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, "Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve" dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore, si dhe në faqen e internetit të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen dhe protokollohen në administratën e Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, në adresën Eqrem Qabej nr. 111.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

**Datum: 02.06.2026. godine**

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno-istraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosovo, br. 11/02. maj 2013. godine), članova 24 i 35, Statuta Instituta za istoriju „Ali Hadri“ Priština (01B-195, od 31.10.2024. godine), članova 21 i 33, člana 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Pravilnika br. 01/31/24 od 31.01.2025. godine o postupcima izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju, članova 4 i 11, Naučno veće Instituta za istoriju „Ali Hadri“ Priština, na sednici održanoj dana 01.06. 2026. godine, objavljuje:

### KONKURS

- Konkurs za izbor/reizbor za radna mesta:
  - Naučni savetnik za savremeni period XX veka.
  - Naučni savetnik za period moderne istorije XVI-XIX veka.
  - Naučni savetnik za period antike.

#### Kandidati/kinje za naučnog savetnika moraju ispunjavati sledeće uslove:

- Da imaju zvanje doktora nauka.
- Da pokažu visok nivo kompetentnosti i naučnog iskustva za oblast (istorijski period) koja se dokazuje.
- Da imaju dve (2) naučne monografske publikacije, jednu nakon poslednjeg izbora, i dva (2) toma sa dokumentima, jedan nakon poslednjeg izbora, iz odgovarajućeg perioda, objavljena od strane naučno-istraživačkih institucija, visokoškolskih ustanova i akademija nauka;
- Najmanje pet (5) naučnih radova objavljenih u relevantnim međunarodnim naučnim časopisima iz odgovarajućeg perioda, od kojih dva (2) nakon poslednjeg izbora, i da je uspešno učestvovao/la u organizovanju naučno-istraživačke delatnosti;
- Da ima aktivno učešće na najmanje tri (3) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna;
- Iskustvo u najmanje dva (2) naučno-istraživačka projekta, realizovana od stranc naučno-istraživačkih i stručnih institucija;
- Sposobnost za rukovođenje naučno-istraživačkim i akademskim projektima.

#### Potrebna dokumentacija

Kandidat/kinja treba da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diplomu o završenim odgovarajućim studijama.
- Diplome stečene u inostranstvu moraju biti nostrifikovane u skladu sa važećim aktima.
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci.
- CV uz koji treba priložiti potrebne dokaze za potvrđivanje stanja navedenog u njemu.
- Dokaze o naučnim dostignućima (članci, knjige, itd.).

Izbor naučnog i istraživačkog osoblja Instituta za istoriju „Ali Hadri“ vrši se u skladu sa odredbama na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno-istraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosova, br. 11/02. maj 2013. godine), Statuta Instituta za istoriju „Ali Hadri“ - Priština (01B-195, od dana 31. oktobra 2024. god.), člana 8 Zakona o radu br. 03/L-212, „Pravilnika o postupcima izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača“ i drugih relevantnih akata Instituta.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednim dnevnim novinama, kao i na internet stranici Instituta za istoriju „Ali Hadri“.

Uz prijavu se prilažu kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i druga potrebna dokumentacija koju zahteva radno mesto za koje konkuriraju.

Popunjene prijave se dostavljaju u protokolišu u administraciji Instituta za istoriju „Ali Hadri“ u Prištini, na adresi Eqrem Qabej br. 111.



Shqiptarë Humanitare, Bamirës e Kosovës "Nina Teresa"  
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"  
Humanitarë Shqiptarë dhe Charitable Society "Mother Teresa"  
38400 Prishtinë, Rr. Agim Ramadani, p.n. Të 00381 38 542 864, Fax: 542 868,  
Web site: www.materteresa.org e-mail: materteresa@yahoo.com

## CONTRACT NOTICE SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 01/06/2026

Procurement No	Training	001	2026	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

### SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

#### I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

<b>Official name:</b> Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
<b>Postal address:</b> str. MujëKrasniqin.n.Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
<b>Contact point(s):</b> Zef Shala		Telephone: 038-542-865
Email: zefshala@hotmail.com		Fax: 038-542-869
Internet address (if applicable):		www.matherteresasociety

### SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

#### II.1) DESCRIPTION

<b>II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:</b> Professional training for 400 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo	
<b>II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance</b> (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)	
	X Services
<b>II.1.5) Short description of the object of the contract</b> Professional training for 400 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo	
<b>II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)</b> 93.000.000.-8	
<b>II.1.7) Variants are accepted</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>II.1.8) Division into lots</b>	NO <input checked="" type="checkbox"/>
Professional training for 400 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo	
<b>II.1.11) Estimated contract value:</b> Approximately 34,500.00	

#### II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

#### II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months	2 month (from the contract signature) or
Starting	15/06/2026
Completion	14/08/2026

### SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

#### III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

<b>III.1.1) Performance security required</b>	NO
<b>III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)</b>	
<b>III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>

#### III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

<b>III.2.1) Eligibility Requirements:</b>	
1. Certificate of Business Registration	
2. Fiscal Number Registration	
3. VAT-Certificate if applicable	
Documentary evidence required	
Copy of documentary	
<b>III.2.2) Professional Suitability:</b>	
1. Business Registration Certificate	
2. List of proposed experts and administrative staff and their cv-s	
3. References of previous experience in similar projects	
Documentary evidence required:	
Copy of prove documents	
<b>III.2.3) Economic and financial capacity</b>	
1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo (for Winner Company only)	
2. Certificate from Justice that's Company and person representative is not on any justice process (for Winner Company only)	
3. Company profile	
Documentary evidence required:	
Copy of documentary	
<b>III.2.4) Technical and professional capacity</b>	
1. Business Registration Certificate	
2. List of proposed experts and administrative staff and their cv-s	
3. References of previous experience in similar projects	
Documentary evidence required:	
Copy of prove documents	

#### III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

<b>III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service</b>	Yes <input checked="" type="checkbox"/>

### SECTION IV: PROCEDURE

#### IV.1) TYPE OF PROCEDURE

<b>IV.1.1) Type of Procedure</b>	
Open	

#### IV.2) AWARD CRITERIA

<b>Lowest price</b>
---------------------

#### IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

<b>IV.3.1) Previous publications concerning the same contract</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier</b>	
Time limit for receipt of requests for tender dossier: date 05/06/2026	
<b>Payable documents</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>IV.3.3) Time limit for receipt of tenders</b>	
Date 10/06/2026 time 14:00 place Prishtina	
<b>IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders</b>	<input checked="" type="checkbox"/> no
<b>IV.3.5) Is tender security needed:</b>	No <input checked="" type="checkbox"/>
<b>IV.3.6) Tender validity period: date: 15/06/2026 days 30 or months1</b>	
<b>IV.3.7) Tender opening meeting:</b>	
Date 10/06/2026 time 14:30 place Prishtina	

### SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

#### V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

#### V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE 01-06-2026 07/2 130 904 1	 Zyra Kombëtare e Auditimit Nacionalna Kancelarija Revizije National Audit Office
<b>NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURSTIT</b>		
Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 22.04.2026 për vendin e punës:		
<b>I. Pozita:</b>	Auditor Junior për Auditim Financiar dhe Pajtuueshmëri	
<b>Numri i pozitave:</b>	Një (1)	
<b>Numri i referencës:</b>	AJAFP/ZKA/06-04/26	
Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 894 të datës 01.06.2026.		
Prishtinë, 01.06.2026	Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	
<b>SAOPËSTENJE O PONIËSTENJU KONKURSA</b>		
Nacionalna kancelarija revizije saopštava da se poništava konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnoj veb stranici i na oglasnoj tabli NKR-a dana 22.04.2026. godine za sledeće radno mesto:		
<b>I. Pozicija:</b>	Junior revizor za finansijsku reviziju i reviziju uskladenosti	
<b>Broj pozicija:</b>	Jedna (1)	
<b>Broj reference:</b>	AJAFP/ZKA/06-04/26	
Konkurs se poništava na osnovu Odluke br. 894 od 01.06.2026.		
Prishtina, 01.06.2026.godine	Odeljenje za upravljanje ljudskim resursima	



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gashi Fasader” SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812020246 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gashi Fasader” D.O.O. Prizren donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812020246 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Gashi Fasader” L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 812020246 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besian Gashi shpall të pavlefshme Diplomën e Masterit të Kolegjit UBT Prishtinë, me nr. 591/45-65.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazdrek.

- Vilson Gjyckaj nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.

- “Restorant te Besi” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Sulejman Vokshi” në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore “Ukshin Miftari”, Skivjan-Gjakovë.

- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Çlirim Gjuraraj nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “7 Shtatori”, nga klasa e 6-9.

- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besian Gashi shpall të pavlefshme Diplomën e Masterit të Kolegjit UBT Prishtinë, me nr. 591/45-65.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazdrek.

- Vilson Gjyckaj nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.

- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.

- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore “Ukshin Miftari”, Skivjan-Gjakovë.

- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Çlirim Gjuraraj nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “7 Shtatori”, nga klasa e 6-9.

- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**

